




01-1080



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 351/04-137725/23 dt. 04.07.2023, të pronarëve Faik Krasniqi, Kadri Osmani, Nazmi Jashanica, Ramë Smajlhasanaj, Muhamed Jashanica, Nysret Morina, Ramadan Gjonbalaj, Ontexi Construction-shpk, Ruhan Krasniqi, Sabit Krasniqi, Hamit Krasniqi, dhe Tefik Krasniqi nga Prishtina dhe investitorit “Ontexi Construction”, me adresë në lagjen Veternik, Komuna Prishtinë, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumë banesore me afarizëm, ndërtuar në Lagjen “Bregu i Diellit”, në rrugën “Arianit Berisha” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 07.12.2023, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET pronarëve Faik Krasniqi, Kadri Osmani, Nazmi Jashanica, Ramë Smajlhasanaj, Muhamed Jashanica, Nysret Morina, Ramadan Gjonbalaj, Ontexi Construction-shpk, Ruhan Krasniqi, Sabit Krasniqi, Hamit Krasniqi, dhe Tefik Krasniqi nga Prishtina dhe investitorit “Ontexi Construction”, lagja Veternik, Komuna Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit ARBK 810798217, me përfaqësues Florin Krasniqi, sipas kërkesës 05 Nr. 351/04-137725/23 dt. 04.07.2023, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, me etazhitet 2B+P+10ET+NK, e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-35061 dt. 03.12.2012, në Lagjen “Bregu i Diellit” në Prishtinë konkretisht në parcelën kadastrale nr. 07899-0, ZK Prishtinë.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugët “Arianit Berisha” ku ka dalje hyrje kjo ndërtesë me numër: 31, në Prishtinë, dhe të njëjtat do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.



Ar sy e t i m

Pronarët Faik Krasniqi, Kadri Osmani, Nazmi Jashanica, Ramë Smajlhasanaj, Muhamed Jashanica, Nysret Morina, Ramadan Gjonbalaj, Ontexi Construction-shpk, Ruhan Krasniqi, Sabit Krasniqi, Hamit Krasniqi, dhe Tefik Krasniqi nga Prishtina dhe investitorit "Ontexi Construction", me certifikatë të regjistrimit ARBK 810798217, me përfaqësues Florin Krasniqi, me kërkesën me 05 Nr. 351/02-137725/23 dt. 04.07.2023, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën shumë banesore me afarizëm, me etazhitet 2B+P+10ET+NK, të ndërtuar në Lagjen "Bregu i Diellit", në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 07899-0, ZK Prishtinë, ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore Ndërtimore 05 Nr. 351-35061 dt. 03.12.2012, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të ndërtesës, nga udhëheqësi i punishtes Hysni Krasniqi; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Rita Arapi; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Feti Selmani; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Burim Dula; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikëqyrësi Asmir Hamdi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Vedatr Jeniçaku; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga kompania e licencuar për kryerjen e matjeve kadastrale "Geo Gaus"Sh.p.k. me nr. të licencës 31;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Komisionit profesional të pranimit teknik, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim nr. 04/L-110, janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesën shumë banesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund të drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI



Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 351/04-137725/23 DT. 07.12.2023

Zyrtari,
Berim Osmanaj

Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi



